

MANUAL PËR
ZBATIMIN E LIGJIT
NR. 06/L-085
**PËR MBROJTJEN E
SINJALIZUESVE**



Autor:
Nur Çeku

“Ky manual u financua përmes grantit të Ambasadës Amerikane në Prishtinë. Mendimet, përfundimet dhe konkludimet apo rekomandimet e shprehura këtu janë të autorit dhe jo medoemos pasqyrojnë qëndrimet e Departamentit të Shtetit”



“ Të gjitha grave dhe burrave që kanë guximin qytetar të raportojnë apo shpalosin shkeljet e ndryshme në kontekstin e marrëdhënieve të tyre të punës në sektorin publik dhe privat me qëllim të mbrojtjes së interesit të përgjithshëm të shtetit të Kosovës.”

Përmbajtja

Sfondi.....	5
Mjedisi legjislativ dhe mbrojtja e sinjalizuesve.....	6
Ligji për mbrojtjen e sinjalizuesve, një instrument efikas	10
Kush mund të jetë sinjalizues?	13
Kuptimi i sinjalizimit	14
Forma dhe përmbajtja e sinjalizimit	17
Sinjalizimi i brendshëm dhe detyrimet e punëdhënësit.....	19
Sinjalizimi i jashtëm dhe procedura e shqyrtimit të tij	23
Sinjalizimi publik apo shpalesja e informacionit	25
Sinjalizimi lidhur me sigurinë kombëtare dhe marrëdhëniet ndërkombëtare	27
Të drejtat e sinjalizuesit dhe personit të lidhur me sinjalizuesin.....	29
Mbrojtja gjyqësore e sinjalizuesit.....	31
Sanksionet kundërvajtëse	35
Mbrojtja e sinjalizuesve në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.....	37
Perspektiva e zbatimit të Ligjit.....	40
Referencat.....	41

Sfondi

Qeverisja demokratike, sundimi i ligjit, zhvillimi ekonomik dhe perspektiva euroatlantike mbeten aspiratat kryesore të shtetit të Kosovës. Për t'u realizuar këto aspirata institucionet publike kanë përgjegjësinë më të madhe, por askush nuk mund të shmanget nga përgjegjësia qytetare për të kontribuar. Misioni i bërjes së Kosovës shtet i së drejtës, i zhvilluar ekonomikisht, me shërbime publike dhe private cilësore, perspektivë integruese dhe shtet normal, arrihet vetëm kur të gjithë qytetarët janë në shërbim të këtij misioni.

Parimet e sundimit të ligjit kërkojnë që veprimet të cilat bëhen për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe interesit publik duhet të jenë të përcaktuara me ligj. Me qëllim të parandalimit në fazat e hershme të shkeljeve të cilat konsiderohen se dëmtojnë interesin publik dhe raportimin apo shpalesjen e tyre, shtetet kanë miratuar legjislationin përkatës. Kjo mundëson që i tërë komuniteti i të punësuarve në sektorin publik dhe privat të raportojnë apo shpalesin shkeljet e ndryshme në kontekstin e marrëdhënieve të tyre të punës. Për më tepër, ky legjislacion mbron dhe garanton të drejtat e personave që raportojnë veprimet e tilla, nga çdo formë e hakmarrjes ndaj tyre.

Edhe Kosova ka miratuar ligjin e veçantë që garanton mbrojtjen e personave që raportojnë dhe shpalesin shkeljet e ndryshme të cilat mund të dëmtojnë interesin publik. Padyshim se ky ligj është një instrument shumë i rëndësishëm për mbrojtjen e interesit publik në Kosovë. Duke integruar standardet ndërkombëtare, ky ligj vlerësohet se do të shërbejë si mjet efikas në parandalimin e shkeljeve në sektorin publik dhe privat. Ligji do të krijojë një mjedis të sigurt për të gjithë të punësuarit që raportojnë veprimet e

tilla, dhe në të njëjtën kohë, një mjedis të pasigurt për të gjithë individët që pretendojnë të përfshihen në shkelje ligjore. Zbatimi i këtij ligji është pa dyshim sprovë për institucionet kosovare, për sektorin privat dhe për qytetarët aktivë, të përkushtuar në mbrojtje të interesit publik. Jeta e një ligji nuk nënkupton hyrjen në fuqi në aspektin formal, por zbatimin e tij efikas në jetën e përditshme.

Të nderuar lexues, mirë se vini në Manualin për zbatimin e Ligjit Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve

Ky manual ka për qëllim të ndihmojë në lehtësimin e të kuptuarit të dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve dhe zbatimit efikas të tij. Manuali është i ndërtuar duke interpretuar dispozitat e Ligjit dhe duke i kontekstualizuar këto dispozita me ligjet tjera në fuqi. Kjo për shkak se zbatimi i shumë dispozitave është i ndërlidhur edhe me ligjet e tjera. Manuali i referohet edhe jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila në disa aktgjykime ka vendosur parime të rëndësishme gjyqësore për mbrojtjen e personave që raportojnë apo shpalesin shkeljet e ndryshme. Ky manual, në rend të parë, u drejtohet komunitetit të punonjësve në sektorin publik dhe privat, të cilët mund të ndeshen me shkelje të ndryshme dhe që kanë vullnetin për t'i sinjalizuar ato. Manuali nuk është dhe nuk mund të jetë një dokument statik, por dinamik, për arsye se Ligji është në fillim të zbatimit të tij dhe praktika mund të tregojë ndryshueshmërinë e tij.

Mjedisi legjislativ dhe mbrojtja e sinjalizuesve

1 Në Kosovë raportimet e përditshme mbulojnë rastet e shumta të korrupsionit, krimit të organizuar, keqadministrimit të drejtësisë, klientelizimit, shkatërrimit të ambientit, diskriminimit dhe shkeljes së të drejtave të njeriut. Menaxhimi i parasë publike, pronave, ndërmarrjeve, punësimet në sektorin publik si dhe prokurimi, vijnë të jenë “zona” rëndë të lëndueshme. Për këtë mjafton t’i referohemi Raportit të vendit (Progresit), Auditorit të Përgjithshëm, Avokatit të Popullit, atyre të shoqërisë civile, etj. Mbrojtja e interesit publik, sundimi i ligjit, shërbimet publike dhe private cilësore, zhvillimi i qëndrueshëm socio-ekonomik, perspektiva euroatlantike vijnë të mbeten një realitet i largët.

2 Por shkeljet ligjore nuk ekzekutohen vetvetiu, ato kalojnë përmes një procesi ideimi, paketimi dhe realizimi. Ato janë produkt i një inxhinieringu njerëzor. Shpesh ato “mbulojnë” shumë mirë pas rregullave dhe procedurave, me ç’rast zbulimi apo të provuarit e tyre është i vështirë. Të punësuarit në sektorin publik dhe privat kanë mundësinë të shohin veprimet përgatitore dhe kryerjen e shkeljeve në dëm të interesit publik. Raportimi i këtyre veprimeve është shumë i rëndësishëm, pasi pengon ekzekutimin e shkeljeve dhe rrjedhimisht shkaktimin e pasojave.

3 Për arsye të ndryshme, komuniteti i të punësuarave në sektorin publik dhe privat në të shumtën e rasteve qëndrojnë të heshtur apo indiferent ndaj këtyre veprimeve. Ata konsiderojnë se mundësia e raportimit nuk është efikase apo se raportimi mund t’u sjellë probleme në vendin e punës në një formë apo tjetër. Sigurisht se të jesh një sinjalizues (apo paralajmërues, informator, njoftues) që raporton një shkelje ligjore në vendin e punës, kërkon guxim dhe aktivizëm qytetar. Aspekti socio-kulturor po ashtu ndikon në pengimin e raportimeve të tilla, pasi në të kaluarën të qenit informator apo sinjalizues është perceptuar si aktivitet i personave të cilët janë servis i pushtetit. Në të gjitha vendet, pothuajse pa përjashtim, sinjalizuesit janë persona të cilët përjetojnë forma të ndryshme të hakmarrjes.

4 Duke vlerësuar rëndësinë e madhe që kanë sinjalizuesit në mbrojtjen e interesit publik, dhe domosdoshmërinë e sigurimit të mbrojtjes ligjore për ta, shumë vende evropiane kanë miratuar ligje të veçanta lidhur me këtë fushë.¹ Mbrojtja dhe mirëqenia e sinjalizuesve, kohët e fundit është duke u trajtuar edhe në nivel të Bashkimit Evropian, përmes Direktivës për mbrojtjen e personave që raportojnë shkeljet e ligjit të Bashkimit Evropian, e cila obligon shtetet anëtare të BE-së (Direktiva) që brenda dy viteve ta transpozojnë në kuadër të legjislacionit të tyre.²

5 Ndërsa në Kosovë, Kushtetuta dhe disa ligje përcaktojnë të drejtën e raportimit për shkeljet ligjore dhe mbrojtjen e personave të cilët bëjnë raportimin. **Kushtetuta e Kosovës në nenin 40 (1) përcakton se:** “Liria e shprehjes është e garantuar. Liria e shprehjes përfshin të drejtën për të shprehur, për të shpërndarë dhe për të marrë informacione, mendime dhe mesazhe të tjera, pa u penguar nga askush”. Kjo dispozitë është e njëjtë me nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Duke iu referuar nenit 10 të Konventës, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka nxjerrë disa nga vendimet kryesore për mbrojtjen e sinjalizuesve.

6 **Kodi Penal i Republikës së Kosovës në nenin 200(2) përcakton se:** “Personi nuk është penalisht përgjegjës sipas paragrafit 1. të këtij neni nëse e ka zbuluar informacionin konfidencial për interes publik, nëse interesi i tillë peshon më shumë se moszbulimi i informatës së fshehtë”. **Neni 388(2) i Kodit Penal përcakton se:** “Kushdo që ndërmerr ndonjë veprim të dëmshëm për cilindo person me qëllim të hakmarrjes për shkak të raportimit ose shpalesjes së informacionit për veprimet dhe mosveprimet që paraqesin kërcënim ose cenim të interesit publik dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy (2) vjet.”³

7 **Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi, në nenin 4 (1.15) përcakton:** “Viktimizimi konsiderohet diskriminim mbi bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, dhe ndodhë kur personi përjeton trajtim të pafavorshëm apo pasoja negative si reagim ndaj ankimit apo mos ankimimit (procedurave të filluara) apo veprimeve me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë, ose në rastet kur personi i tillë ofron informacione, dëshmi apo ndihmë në lidhje me ankesën ose procedurën në rast të diskriminimit”.⁴

¹ Mbretëria e Bashkuar është vendi i parë në Evropë që ka miratuar një akt të tillë të quajtur “The UK’s Public Interest Disclosure Act” (1988). Për trendët e miratimit të ligjeve për shpalesjen e informacionit dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, parimet dhe standardet ndërkombëtare, shih: “Gaps in the System: WhistleblowersLaws in the EU” (2018), Autor: M. Worth; bashkëautor: S. Dreyfus dhe G. Hanley, www.blueprint-forfreespeech.net.

² Transpozimi përfshin masat legjislative dhe administrative, nga autoritetet kompetente një shteti anëtar, për të integruar brenda sistemit ligjor kombëtar detyrimet, të drejtat dhe detyrat e parapara nga Direktiva. Shih Direktivën e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të Bashkimit Evropian për Mbrojtjen e Personave që raportojnë shkeljen e Ligjit në Bashkimin Evropian. Bruksel, 25 shtator 2019. <https://data.consilium.europa.eu/doc/document/PE-78-2019-INIT/en/pdf>.

³ Kodi Nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës/ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 2 /14 janar 2019, Prishtinë.

⁴ Ligji Nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi; Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr. 16 /6 qershor 2015, Prishtinë.

8 Ligji për Agjencinë kundër Korrupsionit, në nenin 19, përcakton:

- 1) Kur një person dyshon për korrupsion, ai/ajo mund të raportojë rastin e tillë në Agjenci;
- 2) Në rast se një person zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare vjen në dijeni në lidhje me veprimin korruptiv, ai/ajo duhet të njoftojë Agjencinë dhe njëkohësisht të ndërmarrë masat e nevojshme për të ruajtur të dhënat në lidhje me sjelljen korruptive;
- 3) Paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni nuk përjashton mundësinë e personit për t'i raportuar rastet drejtpërdrejt tek institucionet tjera kompetente për zbatimin e ligjit".⁵

9 Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, në nenin 7 (1), përcakton: "Pavarësisht çdo detyrimi tjetër ligjor, çdo person që ka njohuri ose dyshim të arsyeshëm për konflikt interesi të ndonjë zyrtari duhet ta lajmërojë institucionin punëdhënës të zyrtarit ose Agjencinë kundër Korrupsionit".⁶

10 Ligji për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, në nenin 18 (5), përcakton: "Nëse një punonjës beson se AKI-ja apo një punonjës i AKI-së mund të ketë shkelur apo po shkel ndonjë ligj, rregullore apo politikë relevante, ai apo ajo duhet t'ia raportojë këtë Inspektorit të Përgjithshëm".⁷

11 Ligji për Klasifikimin e Informacionit dhe Verifikimin e Sigurisë, në nenin 5, përcakton se: "Ndalohet klasifikimi i informacioneve për të: fshehur shkeljet e ligjit, abuzimin e autoritetit, mos efikasitetin apo gabimin administrativ; parandaluar turpërimin e një personi, autoriteti publik apo organizate; ndaluar konkurrencën; apo parandaluar apo vonuar publikimin e një informacioni i cili qartazi nuk ka të bëjë me çështje të sigurisë".⁸

12 Ligji për Mbrojtjen e Informatorëve (lex speciales) është miratuar nga Kuvendi i Kosovës në vitin 2011. Ky ligj kishte si qëllim që të shtynte njerëzit, që në kapacitetin e tyre zyrtar apo si qytetarë, të paraqisnin veprimet kundërligjore.⁹ Por, dispozitat e tij ishin gjenerale dhe të pazbatueshme. Ligji nuk përcaktonte fare sinjalizimin si proces, dhe definonte ngushtë sinjalizuesit duke ua njohur këtë status vetëm punëtorëve që raportojnë brenda institucionit publik ose privat dhe jo edhe atyre që i zbulojnë informatat në media ose në ndonjë institucion tjetër, si prokuroria apo policia.¹⁰

13 Pavarësisht se ky ligj pretendonte të ofronte një kornizë ligjore për paraqitjen e informacioneve për veprimet penale apo kundërvajtëse dhe mbrojtjen e informatorëve, zbatimi i tij në praktikë nuk ka rezultuar efektiv. Ligji për Mbrojtjen e Informatorëve nuk ka ofruar kornizë efektive ligjore as për shpалosjen e informacioneve, dhe nuk ka garantuar mbrojtjen e tyre. Një prej fakteve që vlerësohet se paraqiste pengesë në zbatimin e tij ishte pikërisht emërtimi 'informator'. Ligji për Mbrojtjen e Informatorëve emërtonte sinjalizuesit si informatorë, term ky i papërshtatshëm për popullatën për shkak të konotacioneve historikisht negative gjatë epokës komuniste.¹¹ Në fakt, situata nuk është e njëjtë, pasi tani informatorët (sinjalizuesit) raportojnë për shkeljet ligjore - jo për interesin personal, por në të mirë të interesit publik.

14 Ligji për Mbrojtjen e Informatorëve nuk përcaktonte as sanksionet në rast se pengohej informimi për shkeljet ligjore, apo edhe për dështimin e mekanizmave institucionale në mbrojtjen e informatorëve. Prandaj ky ligj rezultoi se nuk ofronte kornizën ligjore adekuate, dhe gjendja në terren shtronte kërkesën për një ligj të ri, i bazuar në standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare. Ligji aktual mbi informatorët nuk është në përputhje me standardet ndërkombëtare, pasi që ai nuk i plotëson mekanizmat minimale të zbulimit të informacioneve apo kërkesave për mbrojtje.¹² Me qëllim të mbrojtjes së personave të cilët sinjalizojnë shkeljet e ndryshme ligjore në sektorin publik dhe privat, Kuvendi i Kosovës, në vitin 2018, ka miratuar Ligjin për Mbrojtjen e Sinjalizuesve.

"Pavarësisht çdo detyrimi tjetër ligjor, çdo person që ka njohuri ose dyshim të arsyeshëm për konflikt interesi të ndonjë zyrtari duhet ta lajmërojë institucionin punëdhënës të zyrtarit ose Agjencinë kundër Korrupsionit"

⁵ Ligji nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, /Nr.65/05 shkurt 2010, Prishtinë.

⁶ Ligji Nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 5 / 27 prill 2018, Prishtinë.

⁷ Ligji Nr.03/L-063 për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr. 30 /15 qershor 2008, Prishtinë.

⁸ Ligji Nr. 03/L-178 për Klasifikimin e Informacionit dhe Verifikimin e Sigurisë, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Viti V/ Nr. 76 /10 gusht 2010, Prishtinë.

⁹ Ligji Nr. 04/L-043 për Mbrojtjen e Informatorëve, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Nr.14/9 shtator 2011, Prishtinë.

¹⁰ Shih F. Kusari, 'Whistleblowers in Kosovo Struggle for Protection'. Southeast European Coalition on Whistleblower Protection, (9 September 2016). <https://see-whistleblowing.org/whistleblowers-in-kosovo-struggle-for-protection/>

¹¹ K. Gashi, " Kosovo: The Republic without Whistleblowers. Balkan Investigative Reporting Network and Southeast Europe Coalition on Whistleblower Protection (12 September 2016). <https://see-whistleblowing.org/kosovo-the-republic-without-whistleblowers/>.

¹² Raporti i Progresit i Komisionit Evropian i vitit 2016 për Kosovën, Sundimi i Ligjit, fq 17. https://www.meiks.net/repository/docs/20170717114956_raporti_i_progresit_2016_shqip.pdf

Ligji për mbrojtjen e sinjalizuesve, një instrument efikas

15 Ligji Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve (tutje Ligji) është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me datë 23 nëntor 2018. Ligji është publikuar në Gazetën Zyrtare me datë 18 dhjetor 2018, dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas publikimit.¹³ Ndërsa dispozitat që i referohen sektorit privat fillojnë të zbatohen një (1) vit pas hyrjes së tij në fuqi. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji është shfuqizuar Ligji Nr. 04/L-043 për Mbrojtjen e Informatorëve.

16 Qëllimi i Ligjit është krijimi i bazës ligjore për përcaktimin e procedurave të sinjalizimit në sektorin publik dhe privat dhe mbrojtja e sinjalizuesve. Kjo mundëson sinjalizimin e shkeljeve që ndikojnë negativisht në zhvillimin e vendit, duke iu dhënë qasje të punësuarëve për të raportuar veprimet joligjore dhe duke iu ofruar mbrojtje nga frika e hakmarrjes.

Ky ligj paraqet një instrument të rëndësishëm i cili mbron të gjithë të punësuarit në sektorin publik apo privat që në kontekstin e marrëdhënies së tyre të punës, të raportojnë apo shpalosin veprimet joligjore për të cilat mund të kenë informacione. Theksi kryesor i Ligjit është mbrojtja e sinjalizuesve të cilët raportojnë apo i bëjnë publike shkeljet ligjore.

17 Është evident fakti se mjedisi veprues për sinjalizuesit nuk është i favorshëm, jo vetëm në Kosovë por edhe në vende tjera. Ata shpesh mund t'u nënshtrohen formave të ndryshme të hakmarrjes për shpalosjen e veprimeve joligjore në kontekstin e marrëdhënieve në vendin e tyre të punës.¹⁴ Në Kosovë janë disa raste të evidentuara, kur personat të cilët kanë shpalosur informacione të tilla u janë nënshtuar formave të ndryshme të hakmarrjes apo sanksionimit.

Më i njohuri është rasti i A. Thaçit, punëtor i një banke komerciale, i cili gjatë ushtrimit të detyrës së tij kishte vërejtur transaksione të dyshimta dhe keqpërdorim të parasë publike. Ai kishte bërë shpalosjen e informacionit rreth këtij rasti, dhe për pasojë, ishte dënuar në procedurë penale, nën akuzën e shkeljes së rregullativës ligjore të operimit të bankës (legjislacionit penal).¹⁵

18 Procesi demokratik, sundimi i ligjit dhe të drejtat e njeriut janë fryma e këtij Ligji. Të tria këto vlera qëndrojnë të ndërlidhura në mënyrë të natyrshme, të pandashme dhe të ndërvarura nga njëra-tjetra. Të drejtat themelore janë të lidhura ngushtë me të drejtën e shprehjes së lirë dhe të drejtën e qasjes në informacione - si vlera themelore kushtetuese të Republikës së Kosovës.¹⁶ Ligji synon të garantojë që punonjësit e sektorit publik dhe privat të mund të flasin për shkeljet ligjore, dhe se çdo punëdhënës duhet të garantojë që punonjësit të cilët sinjalizojnë akte të tilla të mbrohen nga veprimet e ndryshme të viktimizimit apo hakmarrjes ndaj tyre.

19 Zbatimi i Ligjit pritet të forcojë integritetin dhe llogaridhënien e institucioneve publike nga njëra anë, si dhe do të krijojë parakushte që sektori privat të ofrojë shërbime më efikase, nga ana tjetër. Por zbatimi i suksesshëm i tij parashtron domosdoshmërinë që njerëzit ta kuptojnë përmbajtjen e dispozitave të tij. Çdo i punësuar në sektorin publik apo privat, para se të raportojë apo shpalosë informacione rreth shkeljes ligjore, duhet të ketë njohuri rreth procedurave se si mund ta bëjë këtë. Në të njëjtën kohë është shumë me rëndësi që sinjalizuesit potencialë të kenë njohuri edhe rreth mbrojtjes ligjore që u garantohej për veprimin e ndërmarrë në rast të ballafaqimit. Të punësuarit në sektorin publik dhe privat mund të luajnë një rol aktiv në zbulimin dhe parandalimin e shkeljeve ligjore përmes sinjalizimit.

Procesi demokratik, sundimi i ligjit dhe të drejtat e njeriut janë fryma e këtij Ligji.

¹³ Ligji Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 22 /18 dhjetor 2018, Prishtinë.

¹⁴ Rreth rasteve në vende të ndryshme, shih: Mark Worth and Dr Sulette Dreyfus, Cannelle Lavite, Garreth Hanley, "Safe or Sorry: Whistleblower Protection Laws in Europe Deliver Mixed Results" (2018 Blueprint for Free Speech). www.blueprintforreespeech.net

¹⁵ Rreth këtij rasti shih: F. Kusari, Sinjalizuesi i dyfishtë Thaçi. <https://sbunker.net/teh/42789/sinjalizuesi-i-dyfishte-thaci/>
¹⁶ Shih Nenet: 7, 40 dhe 41 të Kushtetutës.

Zbatimi Ligjit pritet të forcojë integritetin dhe llogaridhënien e institucioneve publike, nga njëra anë si dhe do të krijojë parakushte që sektori privat të ofrojë shërbime më efikase, nga ana tjetër.

20 Ligji përmban standarde ndërkombëtare për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve. Lidhur me rregullimin ligjor për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, shtetet e ndryshme kanë praktika të ndryshme. Disa shtete këtë e rregullojnë me legjislacion penal. Shtete tjera e kanë të shpërndarë në disa ligje, si në legjislacionin penal apo në atë të punës. Disa shtete, me theks të veçantë të Evropës, këtë fushë e rregullojnë me ligj të veçantë (lex speciales). Mirëpo, standardet ndërkombëtare sugjerojnë se:

- 1) duhet të ketë një ligj që rregullon në mënyrë gjithëpërfshirëse sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve;
- 2) ligji të ketë fushëveprim në sektorin publik dhe privat;
- 3) institucionet e sektorit publik dhe privat kanë për obligim t'i trajtojnë sinjalizimet e raportuara, dhe
- 4) institucionet e sektorit publik dhe privat duhet të garantojnë mbrojtje ligjore të sinjalizuesve nga çfarëdo veprimi hakmarrës.¹⁷

Kush mund të jetë sinjalizues?

21 Sinjalizues mund të jetë secili person i cili në kontekstin e marrëdhënies së tij të punës raporton apo shpalos informacione për një kërcënim apo cenim të interesit publik që ndodh në sektorin publik ose në atë privat. Shprehja **“në kontekstin e marrëdhënies së punës”**, nënkupton jo vetëm personat të cilët punojnë aktualisht por edhe personat të cilët kanë punuar më parë, apo janë në kontakt në kuadër të lidhshmërisë së punës së tyre me një organizatë të sektorit publik apo privat. Ky përkufizim është bërë me qëllim të zgjerimit të personave të cilët mund të jenë sinjalizues.¹⁸

22 Janë katër kategori të personave që mund të jenë sinjalizues në kontekstin e marrëdhënies së tyre të punës:

- 1) personat që punojnë në organizatat e sektorit publik dhe privat, pavarësisht nga natyra e punës, kohëzgjatja apo pagesa;
- 2) bashkëpunëtorët e jashtëm, të rastit, vullnetarët apo praktikantët profesionalë;
- 3) kandidatët për punësim, aktivitetet vullnetare, praktikantët profesionalë ose trajnimet, dhe
- 4) marrëdhëniet kontraktore apo nënkontraktorë punësh e shërbimesh në institucionet publike dhe private.

23 Ligji përcakton se sinjalizuesi raporton apo shpalos informacione për një kërcënim apo cenim të interesit publik. Kërcënimimi është veprimi apo mosveprimi i cili rrezikon interesin publik, ndërsa cenimi paraqet veprimin apo mosveprimin me të cilin cenohet, lëndohet apo shkaktohet ndonjë pasojë apo dëm i interesit publik. Përkufizimet e termit *“interes publik”* janë të shumta, dhe se një përkufizim integruar mund të jetë si një vijim: interesi publik përfshin shumë aspekte të cilësisë së jetës njerëzore, duke filluar me të drejtat themelore të njeriut, sigurinë njerëzore, zhvillimin ekonomik, mirëqenien sociale, dinjitetin dhe lumturinë e njerëzve dhe trashëgiminë e vlerave kulturore.¹⁹

¹⁷ Ligji ka integruar parimet dhe standardet evropiane të parapara me Rekomandimin e Këshillit të Evropës (2014)7 dhe Projekt Direktivën e Parlamentit dhe Këshillit Evropian për Mbrojtjen e Sinjalizuesve.

¹⁸ Për sinjalizuesit përdoren emra të ndryshëm, si: informator, njoftues, raportues. Në gjuhën angleze përdoret shprehja 'whistleblower.'
¹⁹ Legjislacioni kosovar, në dy raste i referohet definimit të interesit publik. Kodi Penal, në Nenin 200(4), përcakton: "Interes publik nënkupton që mirëqenia e përgjithshme e publikut mbipeshon interesin individual. Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, në Nenin 3 (1.1.1), përcakton: 'Interes publik - interesi material ose jo material i ligjshëm dhe i drejtë në dobi të qytetarëve'.

Kuptimi i sinjalizimit

24 Sinjalizimi në kuptim të përgjithshëm është **raportimi** apo **shpalosja** e informacioneve apo veprimeve që konsiderohen joligjore, joetike, jokorrekte brenda një organizate, qoftë kjo në kuadër të sektorit publik apo privat. Ligji përcakton se ky akt raportimi apo shpalosje duhet të bëhet për veprimet apo mosveprimet të cilat paraqesin kërcënim apo cenim të interesit publik. Raportimi është sinjalizimi i shkeljeve që bëhet brenda institucionit të sektorit publik apo privat, apo raportimi tek institucioni i jashtëm kompetent. Shpalosja, nga ana tjetër, është sinjalizimi që bëhet jashtë institucionit ku ka ndodhur shkelja dhe jashtë organit kompetent për trajtimin e sinjalizimit të jashtëm. Në fakt, shpalosja është bërja publike apo akt zbulimi i cili i vëhet në dispozicion publikut të gjerë.

25 Sinjalizimi në formën e raportimit apo shpalosjes - për të qenë i mbrojtur duhet të bëhet për rastet e shkeljeve të parapara me ligj. Termi “shkelje” është gjithëpërfshirës dhe Ligji nuk e definon në kuadër të përkufizimeve se çka është një “shkelje”.²⁰ Por, nga përmbajtja e Nenit 5 përcaktohet se një shkelje paraqet një veprim apo mosveprim në rastet si në vijim:

- 1) dështimi i një personi për të përmbushur një detyrim ligjor;
- 2) keqadministrimi i drejtësisë;
- 3) rrezikimi i shëndetit dhe sigurisë së individit;
- 4) dëmtimi i ambientit;
- 5) keqpërdorimi i pozitës zyrtare;
- 6) keqpërdorimi apo keqmenaxhimi i parave publike;
- 7) një veprim apo mosveprim i një institucioni (apo në emër të tij) është diskriminues, shtypës, kryhet nga pakujdesia apo përbën keqmenaxhim të rëndë dhe veprimi i fshehur apo për të shkatërruar informatat lidhur me këto shkelje.

Fushat e listuara në nenin 5 të Ligjit janë shumë të përgjithësuara dhe në kuadër të tyre mund të ndodhin shkelje të ndryshme.

26 Aspekti kohor i sinjalizimit të shkeljeve është shumë i rëndësishëm. Ligji përcakton se ato mund të raportohen apo shpalosen nëse **“shkelja është kryer, është duke u kryer apo ka gjasa që të kryhet.”** Varësisht në çfarë faze sinjalizohet një shkelje, përmes sinjalizimit mund të pengohet shkaktimi i dëmit, mund të bëhet parandalimi i shkeljes apo praktikës dyshuese.

27 Në praktikën krahasuese, legjislati i përcakton për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve në disa shtete u referohet vetëm veprave apo praktikave të korrupsionit dhe jo shkeljeve tjera.²¹ Direktiva Evropiane, në nenin 2 përcakton tri kategori të shkeljeve të mundshme të cilat mund të sinjalizohen.

Kategoria e parë liston një katalog të fushave ku mund të ketë shkelje si në vijim:

- 1) prokurimi publik;
- 2) shërbimet financiare, produktet dhe tregjet, dhe parandalimi i pastrimit të parave dhe financimi i terrorizmit;
- 3) sigurinë dhe pajtueshmërinë e produktit;
- 4) siguria e transportit;
- 5) mbrojtja e mjedisit;
- 6) mbrojtja nga rrezatimi dhe siguria bërthamore;
- 7) siguria e ushqimit, shëndetit dhe mirëqenia e kafshëve;
- 8) shëndeti publik;
- 9) mbrojtja e konsumatorit;
- 10) mbrojtja e privatësisë dhe të dhënave personale, dhe
- 11) siguria e rrjeteve dhe sistemeve të informacionit.

Kategoria e dytë përfshin shkeljet që ndikojnë në interesat financiare të Bashkimit Evropian,

siç përmendet në nenin 325 të TBE dhe luftimin e krimit ekonomik.²²

Kategoria e tretë përfshin shkelje në lidhje me tregun e brendshëm, siç përcaktohet me nenin 26(2) të TBE²³, të cilat kanë të bëjnë me shkeljet e konkurrencës, të ndihmës shtetërore, të tatimit të korporatave.

28 Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve përfshin disa fusha, në kuadër të së cilave mund të ndodhin shkelje të ndryshme. Disa nga fushat janë të mbuluara me legjislatin penal, disa me ligje apo akte tjera, dhe vetëm pas trajtimit (filtrimit) të sinjalizimit mund të kualifikohet se për çfarë lloje shkeljesh kemi të bëjmë. Shkeljet mund të jenë veprime që ndodhin vetëm një herë ose sjellje që përsëriten. Një sërë shkeljesh të vogla të bëra bashkë mund të përbëjnë një shkelje të rëndë.²⁴

Sinjalizimi është **raportimi** apo **shpalosja** e informacioneve ose veprimeve që konsiderohen joligjore, joetike ose jokorrekte brenda një organizate

²⁰ Neni 5, Ligji Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve.

²¹ Shih Ligjin Nr. 01, 02 -02010-39/13 date 16.12. 2013 për mbrojtjen e personave që raportojnë korrupsion në institucionet e Bosnje dhe Hercegovinës. http://sps.gov.ba/dokumenti/korupcija/Korupcija_zakon.pdf.
Shih Ligjin nr. 60/2016 për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve në Shqipëri. <https://univlora.edu.al/wp-content/uploads/2018/01/ligj-nr-60-dt-per-sinjalizimin-dhe-mbrojtjen-sinjalizuesve.pdf>.

²² Neni 325(1) i TBE, përcakton se “Bashkimi Evropian dhe shtetet anëtare luftojnë krimin ekonomik dhe çdo aktivitet tjetër të paligjshëm që prek interesat e Bashkimit Evropian, përmes masave që duhen marrë në përputhje me këtë nen, të cilat veprojnë si frenues dhe janë të tilla që ofrojnë mbrojtje efektive në shtetet anëtare dhe në të gjitha institucionet, organet, zyrat dhe agjencitë e Bashkimit Evropian.” https://www.mei-ks.net/repository/docs/Traktati_i_Lisbones_-_Verzioni_i_Konsoliduar.pdf.

²³ Neni 26(2) i TBE përcakton se: “Tregu i brendshëm përfshin një zonë pa kufij të brendshëm, në të cilën sigurohet lëvizja e lirë mallrave, personave, shërbimeve dhe kapitalit, në përputhje me dispozitat e Traktateve”.

²⁴ Udhëzuesi për Mbrojtjen e Sinjalizuesve. Këshilli i Evropës, qershor 2019. Aautor: Wim Vandekerckhove, Ekspert i Këshillit të Evropës. fq 8. Ky udhëzues gjendet në: <https://rm.coe.int/handbook-on-protection-of-whistleblowers-alb/168097ed0c>.

29 Mbrojtja e sinjalizuesve sipas Ligjit përjashtohet në rastet si vijon:

- 1) sinjalizimi nuk është kryer për shkaqet e përcaktuara në nenin 5 të Ligjit;
- 2) raportimi apo shpalosja kryhet në bazë të fakteve, informatave ose dokumenteve që sigurohen lidhur me dhënien e ndihmës juridike²⁵;
- 3) sinjalizuesi raporton ose shpalos informacionin që ai e ka ose mund të ketë dijeni se është i rremë.

Aspekti kohor i sinjalizimit të shkeljeve është shumë i rëndësishëm. Ligji përcakton se ato mund të raportohen apo shpalosen nëse **“shkelja është kryer, është duke u kryer apo ka gjasa që të kryhet.”**

Forma dhe përmbajtja e sinjalizimit

30 Sinjalizimi mund të bëhet në tri forma:

- 1) me shkrim;
- 2) me postë/e-mail dhe
- 3) gojarisht.

Sinjalizimi përmes këtyre formave duhet të përmbajë informacione të qarta, kredibile dhe relevante. Për aq sa është e mundur, shkelja e pretenduar duhet të jetë e referuar në bazën ligjore. Informatat duhet të përmbajnë të dhënat e personit kundër të cilit paraqitet sinjalizimi.²⁶ Pra, emrin personal, pozitën/vendin e punës, përshkrimin e veprimeve/fakteve për shkelje të mundshme për të cilat pretendohet.

31 Në fakt, dy format e para të sinjalizimit janë forma që bëhen me shkrim, mirëpo mënyra e sinjalizimit dallon. Sinjalizimi me shkrim bëhet në rastet kur sinjalizuesi harton informatën (raportin/njoftimin apo deklaratën) me shkrim rreth shkeljes së pretenduar.

Informatat duhet të jenë të sistemuara qartë dhe të mbështetura në faktet e pretenduara. Raportit i bashkëngjiten edhe faktet të cilat mund t'i ketë në dispozicion sinjalizuesi. Në rastet kur sinjalizuesi e dorëzon informacionin personalisht tek zyrtari përgjegjës apo tek organi komptent, konsiderohet si raportim me shkrim.²⁷ Kjo formë mund të konsiderohet forma më e përshtatshme e sinjalizimit.

32 Sinjalizimi me postë/ e-mail, bëhet në rastet kur sinjalizuesi harton informatën (raportin/deklaratën) rreth shkeljeve të pretenduara dhe të njëjtën e dërgon tek mekanizmi kompetent përmes postës klasike/ apo elektronike. Sinjalizimi përmes e-mailit bëhet në rastet kur sinjalizuesi e dërgon informacionin me postë elektronike. Por sinjalizuesi duhet të jetë i njoftuar se kjo mund të mos jetë forma më e sigurt nëse informacioni është konfidencial. E-maili kurrë nuk është privat dhe mesazhi juaj mund të përcjellet tek njerëz të tjerë pa dijeninë tuaj. Një kopje rezervë e email-it tuaj është e ruajtur gjithmonë në një server ku mund të shikohet.²⁸

²⁵ Nuk është i mbrojtur sinjalizimi i cili bëhet nga informatat konfidenciale - të komunikimeve mes avokatëve dhe klientëve të tyre ('legal professional privilege right').

²⁶ Ligji nuk e definon personin kundër të cilit paraqitet sinjalizimi në lidhje me shkeljet e ndryshme. Direktiva e BE-së e përcakton këtë person si person i interesuar, që nënkupton se "një person fizik ose juridik të cilit i referohet një raport ose një publikim publik si një person të cilit i atribuohet shkelja ose me të cilin është lidhur ai person";

²⁷ Lidhur me formën e raportimit të brendshëm si model orientues, mund të shërbejë skema e paraqitur në Udhëzuesin për Mbrojtjen e Sinjalizuesve. Këshilli i Evropës, qershor 2019. Autor: Wim Vandekerckhove, Ekspert i Këshillit të Evropës. Ky udhëzues gjendet në: <https://rm.coe.int/handbook-on-protection-of-whistleblowers-alb/168097ed0c>.

²⁸ Shih Udhëzuesin "Komunikimi efektiv përmes postës elektronike - Email", Bahrie Lecaj, Dhjetor 2013 USAID.

33 Sinjalizimi i bërë gojarisht paraqet një formë të sinjalizimit ku sinjalizuesi raporton apo shpalos gojarisht informacionin tek organi kompetent. Ligji përcakton se për të qenë i vlefshëm raportimi verbal, zyrtari përgjegjës i organit kompetent përpilon një deklaratë me shkrim e cila ndërtohet mbi rrëfimin e bërë nga sinjalizuesi, dhe të njëjtën deklaratë e nënshkruajnë personi përgjegjës dhe sinjalizuesi.

34 Është me rëndësi fakti se sinjalizimi është i vullnetshëm dhe askush nuk mund të detyrohet të bëjë sinjalizim. Në rastet kur paraqitet sinjalizimi zyrtari përgjegjës dhe organi kompetent janë të detyruar të pranojnë dhe evidentojnë sinjalizimin duke krijuar një regjistër (dosje) i cili duhet të përmbajë të dhënat si në vijim:

- 1) datën e pranimit;
- 2) emrin dhe mbiemrin e sinjalizuesit;
- 3) të dhënat e kontaktit të sinjalizuesit;
- 4) institucionin e sinjalizuesit;
- 5) përmbajtjen e shkurtër të informatës së paraqitur. Sinjalizuesit i jepet një dëshmi për sinjalizimin e paraqitur, bashkë me një listë (fletë evidencë) të dokumenteve të paraqitura bashkë me sinjalizimin.

35 Secili veprim ose mosveprim që synon pengimin e sinjalizimit është i pavlefshëm. Zyrtari përgjegjës apo cilido person tjetër që pengon procesin e sinjalizimit ndiqet penalisht sipas dispozitave penale në fuqi në Kosovë. Ligji përcakton detyrimin se nuk mund të ketë asnjë marrëveshje/kontratë e cila mund të bëhet duke shmangur zbatimin e dispozitave për ndalimin apo kufizimin e raportimit apo shpalosjes së informatave në interes të publikut.

36 Ligji parashikon tri lloje të sinjalizimit: i brendshëm, i jashtëm dhe publik.

Sinjalizimi i brendshëm dhe detyrimet e punëdhënësit

37 Sinjalizimi i brendshëm është raportimi i kryer nga sinjalizuesi brenda organizatës ku punon, qoftë në sektorin publik apo privat. Fryma e ligjit është që fillimisht sinjalizimi duhet të bëhet brenda organizatës. Sinjalizimi i brendshëm konsiderohet si mënyra më e mirë për të marrë informacione relevante të cilat mund të kontribuojnë në zgjidhjen e hershme dhe efektive të rreziqeve për interesin publik dhe shmangien e pasojave. Ligji detyron të gjitha entitetet ligjore të sektorit publik dhe privat të krijojnë kanalet e raportimit të brendshëm në përpjestim me madhësinë e tyre.

38 Institucionet publike të cilat kanë më shumë se pesëmbëdhjetë (15) persona të punësuar janë të detyruar të caktojnë zyrtarin përgjegjës si kanal të brendshëm raportimi. Ky detyrim vlen për të gjitha organet, autoritetet dhe agjencitë publike si të nivelit qendror ashtu edhe atij lokal, të cilat ushtrojnë kompetenca legjislativë, administrative, gjyqësore, prokuroriale apo institucione të tjera publike të përcaktuara me ligje të veçanta.

39 Subjektet private të cilat kanë më shumë se pesëdhjetë (50) persona të punësuar janë të detyruara të caktojnë zyrtarin përgjegjës si kanal të brendshëm raportimi. Subjekte të sektorit privat janë:

- 1) shoqëritë tregtare;²⁹
- 2) personat juridik sipas ligjit për lirinë e asociimit³⁰ dhe
- 3) persona tjerë juridik të përcaktuar me ligj.

²⁹ Neni 3 (1.1.22.) i Ligjit për Shoqëri Tregtare përcakton se "Shoqëri tregtare përfshin çfarëdo lloji të shoqërisë tregtare të themeluar në Kosovë sipas këtij ligji apo të një ligji tjetër duke përfshirë bizneset individuale, ortakëritë e përgjithshme, ortakëritë e kufizuara, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionare". Ligji Nr. 06/L -016 për Shoqëritë tregtare/ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 9 / 24 Maj 2018, Prishtinë.

³⁰ Neni 3 (1.1.2) i Ligjit për Lirinë e asociimit në organizata joqeveritare përcakton "Organizata Joqeveritare (OJQ)" - është person juridik i pa-varur dhe jo për përfitim, i themeluar për realizimin e qëllimeve të ligjshme për përfitim publik ose interes të ndërsjellë". Ligji Nr.06/L-043 për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare/ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.11/24 Prill 2019, Prishtinë.

- 40** Procedura e hetimit administrativ të sinjalizimit të brendshëm fillon në momentin e raportimit të informacionit të sinjalizuar te zyrtari përgjegjës i caktuar në kuadër të institucionit. Raportimi mund të bëhet në një nga tri format e sinjalizimit. Brenda një afati prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të sinjalizimit, punëdhënësi³¹ e njofton sinjalizuesin për pranimin apo refuzimin e sinjalizimit. Zyrtari përgjegjës e shqyrton informacionin e raportuar dhe varësisht nga vlerësimi, vendos nëse janë plotësuar kushtet për t'u pranuar sinjalizimi dhe që personi raportues të marrë cilësinë e sinjalizuesit.
- 41** Zyrtari përgjegjës i caktuar në institucionet e sektorit publik dhe privat padyshim se ka një rol shumë të rëndësishëm në zbatimin e Ligjit. Trajtimi i sinjalizimit është çështje e ndjeshme dhe për këtë arsye zyrtari duhet të udhëhiqet nga parimet profesionale, politikisht neutrale dhe duke shmangur konfliktin e interesit. Parimi i konfidencialitetit të informatave tek raportimi i brendshëm është parim kryesor i cili duhet të udhëheq zyrtarin përgjegjës gjatë gjithë procesit të hetimit administrativ.
- 42** Ligji përcakton se zyrtari përgjegjës dhe çdo person tjetër, i cili gjatë kryerjes së detyrës së tyre zyrtare pranon dhe trajton informacione të raportuara në interes publik, duhet t'i ruajë ato në mënyrë konfidenciale. Sipas këtij detyrimi, informacioni i raportuar nuk duhet të transmetohet tek personat e tretë, qoftë brenda institucionit apo jashtë tij, dhe i njëjti informacion nuk mund të përdoret për qëllime tjera. Përjashtimisht, kjo mund të bëhet në dy situata:
- 1) me pëlqimin me shkrim të sinjalizuesit dhe
 - 2) për të përmbushur një detyrim ligjor.³²
- 43** Lidhur me kohëzgjatjen e procedurës së hetimit administrativ, Ligji përcakton se kjo procedurë duhet të përfundojë sa më shpejt që është e mundur dhe në çdo rast, jo më vonë se dyzetepesë (45) ditë nga momenti i raportimit të informacionit të sinjalizuar. Nëse rrethanat e rastit janë komplekse, ky afat mund të shtyhet vetëm një herë por jo më shumë se dyzetë e pesë (45) ditë tjera.³³

- 44** Në fazën e hetimit administrativ, zyrtari përgjegjës shqyrton dhe vlerëson pretendimet e ngritura nga sinjalizuesi. Gjatë fazës së hetimit administrativ, zyrtari përgjegjës mund të kërkojë:

- 1) informacion shtesë dhe dokumente relevante;
- 2) të urdhërojë inspektime ose të marrë deklaratë nga personat në dijeni për çështjen; si dhe
- 3) të konsultohet me ekspertë të fushës përkatëse.

Gjatë hetimit administrativ, zbatohen dispozitat e legjislacionit për procedurën e përgjithshme administrative dhe çdo pale pjesëmarrëse i garantohet një proces i rregullt, dhe pala mund të:

- 1) japë deklaratë me shkrim;
- 2) paraqesë prova ose opinione;
- 3) ka të drejtë të dëgjohet në lidhje me pretendimet e tij; dhe
- 4) mund të konsultohet me dosjen e hetimit.

- 45** Gjatë procedurës së hetimit administrativ të sinjalizimit të brendshëm, palët pjesëmarrëse kanë të drejtë të përdorin gjuhën e tyre, në pajtim me ligjin për gjuhët.³⁴ Edhe pse Ligji nuk ka dispozitë të caktuar për përdorimin e gjuhës zyrtare, gjatë procesit administrativ të sinjalizimit kjo rregullohet me dispozitat e ligjit për gjuhët dhe dispozitat e ligjit për procedurën e përgjithshme administrative.

Këto dispozita mes tjerash garantojnë të drejtën e sinjalizuesit që të mos ketë kosto buxhetore rreth përdorimit të gjuhës zyrtare. Kjo mund të jetë në rastet kur sinjalizuesi apo zyrtari administrativ apo personi i tretë flasin një gjuhë tjetër zyrtare dhe nevojitet përkthimi i dokumenteve, etj. Në këtë situatë, sinjalizuesi nuk ka detyrim të sigurojnë përkthimin dhe ky është obligim i punëdhënësit (organizatës që zhvillon procedurën).

- 46** Gjatë hetimit administrativ punëdhënësi duhet të vendosë në dispozicion dokumentacionin dhe provat të cilat i posedon. Këto prova dhe dokumente përdoren nëse janë relevante për procesin e hetimit administrativ dhe të njejtat nuk mund të përdoren përtej këtij qëllimi. Pas përfundimit të hetimit administrativ të sinjalizimit, nëse rezulton se veprimi ose praktika e raportuar përbën ose mund të përbëjë një shkelje ligjore, punëdhënësi vë në dijeni organin kompetent.³⁵ Nëse veprimi apo praktika e raportuar ka shkaktuar pasoja të dëmshme, punëdhënësi duhet të ndër marrë veprime të menjëhershme, për aq sa është e mundur, për të parandaluar ose penguar vazhdimin e këtyre pasojave.

³¹ Punëdhënësi në fakt, këtu ka kuptimin e titullarit të punëdhënësit. Zbatimi i kësaj dispozite duhet të përpunohet me Aktin nënligjor për procedurën për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit të brendshëm.

³² Për të përmbushur një detyrim ligjor, Ligji përcakton katër rastet si në vijim: 1) hetimin efektiv të shkeljeve ligjore; 2) parandalimin serioz për sigurinë e shtetit, sigurinë publike dhe shëndetin publik dhe mjedisin; 3) parandalimin e krimit apo ndjekjes penale; 4) zbulimi në interes publik është domosdoshmëri që kërkohet me ligj.

³³ Ky afat është në pajtim me dispozitat (neni 98 dhe 99) e Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën Administrative, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Nr. 20/21/ Qershor 2016. Prishtinë.

³⁴ Shih nenin 2 dhe 4 të Ligjit Nr. 02/L-37, për Përdorimin e Gjuhëve; Gazeta Zyrtare e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë / Prishtinë :Viti II / nr. 10 / 01 mars 2007.

³⁵ Organ kompetent i cili mund të vihet në dijeni pas përfundimit të një hetimi administrativ mund të jenë organet e ndryshme për zbatimin e ligjit nga fushëveprimi i tyre: Agjencia Kundër Korrupsionit, Policia, Prokuroria, Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, Avokati i Popullit, Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Agjencia e Inteligjencës Financiare, Dogana e Kosovës, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës, Administrata Tatimore etj.

47 Punëdhënësi është i obliguar të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme në lidhje me sinjalizimin duke përfshirë:

- 1) mbrojtjen nga zhdukja të dokumentacionit dhe provave lidhur me sinjalizimin dhe
- 2) fshehja, ndryshimi, falsifikimi dhe veprime të tjera, të cilat synojnë dëmtimin ose asgjësimin e tyre.

Punëdhënësi është i obliguar të mbrojë sinjalizuesin nga çdo veprim i dëmshëm dhe të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të ndërprerë veprimin e dëmshëm si dhe të largojë çdo pasojë të një veprimi të dëmshëm.

**Gjatë procedurës së
traitimit administrativ
të sinjalizimit, palët
pjesëmarrëse kanë
të drejtë të përdorin
gjuhën e tyre, në pajtim
me ligjin për gjuhët.**

48 Ligji parimisht, përcakton se sinjalizmi bëhet tek zyrtari përgjegjës por përjashtimisht, sinjalizuesi mund t'i drejtohet drejtpërdrejt drejtuesit të punëdhënësit, në rastet kur:

- 1) punëdhënësi nuk ka zyrtar përgjegjës;
- 2) punëdhënësi nuk ka përcaktuar dhe publikuar procedura të brendshme për pranimin dhe trajtimin e sinjalizimeve;
- 3) sinjalizuesi ka dyshime të arsyeshme se zyrtari përgjegjës është ose mund të përfshihet në praktikën e dyshuar të sinjalizimit;
- 4) sinjalizuesi ka dyshime të arsyeshme se zyrtari përgjegjës për shkak të çfarëdo marrëdhënie ose shoqërie me një person që është ose mund të jetë i përfshirë në çështjen e pretenduar në sinjalizim, nuk është personi i përshtatshëm për t'u informuar sinjalizimi;
- 5) sinjalizuesi ka dyshime të arsyeshme se procedurat e brendshme të sinjalizimit nuk janë efektive. Në këto raste drejtuesi (titullari) i institucionit është personi përgjegjës për trajtimin e sinjalizimit.³⁶

Sinjalizimi i jashtëm dhe procedura e shqyrtimit të tij

49 Sinjalizimi i jashtëm është raportimi që sinjalizuesi bën tek autoriteti kompetent jashtë institucionit ku ai punon. Standardet ndërkombëtare kërkojnë që ky autoritet të jetë i themeluar me ligj dhe të ketë pavarësi në funksionimin e tij. Këto institucione duhet të kenë aftësinë operuese që të sigurojnë integritetin dhe konfidencialitetin e informacionit të raportuar dhe parandalojnë qasjen e personave jokompetent në këtë informacion. Autoritetet kompetente të cilat pranojnë raportime, të jashtme, nuk janë të modeluara që të veprojnë si shkallë instancionale e organeve që trajtojnë sinjalizim të brendshëm. Ato nuk kanë mandat të ndryshojnë dhe plotësojnë vendimet e nxjerra nga procesi i sinjalizimit të brendshëm. Por kjo nuk pengon apo përjashton mundësinë që institucionet të cilat trajtojnë sinjalizimin e jashtëm të shqyrtojnë një rast të njëjtë, i cili paraprakisht është shqyrtuar brenda institucionit të sektorit publik apo privat si sinjalizim i brendshëm, dhe të kenë gjetje apo përfundime të tjera.

50 Sinjalizuesi mund të bëjë sinjalizim të jashtëm pasi ka kryer sinjalizimin e brendshëm apo të bëjë drejtpërdrejt sinjalizim të jashtëm, në rastet kur:

- 1) sinjalizimi ka të bëjë me drejtuesin e punëdhënësit;
- 2) sinjalizimi ka karakter urgjent që ndërlihet me një rrezik të rëndë dhe të menjëhershëm ose me dëme të pakthyeshme;
- 3) ka dyshime të arsyeshme se mund të ndërmerren veprime të dëmshme ndaj sinjalizuesit, se provat mund të fshihen ose asgjësohen nëse ky do të kryente sinjalizim të brendshëm;
- 4) kur sinjalizuesi ka dyshime të arsyeshme se procedurat e brendshme të sinjalizimit nuk janë efektive.

³⁶ Neni 17(5) i Ligjit përcakton se "Qeveria, sipas propozimit të Ministrisë së Drejtësisë, me akt nënligjor përcakton procedurën për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit në sektorin publik. Subjektet private përcaktojnë procedurën për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit më akt të brendshëm, në pajtim me këtë ligj.

51 Procedura për sinjalizim të jashtëm për sektorin publik inicohet me raportimin e informacionit tek Agjencia kundër Korrupsionit. Ligji përcakton se kjo Agjenci shqyrton rastet e sinjalizimit që bien në fushëveprimin e vet, pra rastet e korrupsionit dhe ato të parandalimit të konfliktit të interesit.³⁷ Nëse Agjencia nuk ka kompetencë për të vepruar, e përcjellë pa vonesë informatën tek autoriteti tjetër kompetent i cili ka mandat për të vepruar nga fushëveprimi i vet specifik. Në rastet kur Agjencia dërgon rastin tek autoritetet tjera, e informon sinjalizuesin për një veprim të tillë. Në rastet kur sinjalizuesi nuk pranon t'i zbulohet identiteti dhe Agjencia kundër Korrupsionit nuk ka kompetencë për ta trajtuar informatën para se ta përcjellë atë tek autoriteti tjetër kompetent, ajo kërkon miratimin e sinjalizuesit, përveç nëse është paraparë ndryshe me ligj.

52 Me kërkesë të sinjalizuesit, autoriteti kompetent i jep atij informata për statusin e procedurës dhe për të gjitha veprimet e ndërmarra, dhe i mundëson atij që të ketë qasje në shkresat e lëndës si dhe të marrë pjesë në veprimet gjatë procedurës, në pajtim me ligjin. Autoriteti kompetent e njofton sinjalizuesin për rezultatin e procedurës pas përfundimit të saj. Procedura e trajtimit të sinjalizimit të jashtëm është e njëjtë me atë të sinjalizimit të brendshëm (shih pikat 34-37 të këtij manuali).

53 Sa i përket sinjalizimit të jashtëm në sektorin privat, Ligji përcakton se sinjalizuesi mund ta bëjë sinjalizimin tek rregullatorët e ndryshëm sipas fushave të përgjegjesisë së tyre. Sipas legjislationit

“Agjencia Rregullatore bën rregullimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së operatorëve të një tregu të caktuar me qëllim të mbrojtjes së konsumatorëve dhe sigurimit të konkurrencës së lirë”.³⁸

Sinjalizimi publik apo shpalosja e informacionit

54 Ligji përcakton se sinjalizuesi, përveç sinjalizimit të brendshëm dhe të jashtëm, mund të bëjë edhe sinjalizim publik apo shpalosjen e informacionit. Shpalosja nënkupton vënien e informacionit në dispozicion të publikut për shkeljet e pretenduara dhe kjo mund të bëhet përmes takimeve apo mbledhjeve publike, mediave të shkruara dhe elektronike, OJQ-ve, organizimeve sindikale, shoqatave afariste, odave zejtare, tregtare, ekomomike, etj. Mirëpo, që sinjalizimi i jashtëm të jetë i mbrojtur, sinjalizuesi duhet të bëjë shpalosjen e informacionit sipas kriterëve të përcaktuara ligjore në dy situata.

55 Situata e parë përfshinë tri kriteret ligjore kur sinjalizuesi mund të bëjë shpalosje të informacionit që ka të bëjë me dështimin apo mosveprimin e duhur apo hakmarrës nga mekanizmat institucional për trajtimin e sinjalizimit të brendshëm dhe të jashtëm janë si vijon:

1) me arsye beson se ai do t'i nënshtrohet ndëshkimit nëse bën raportim të brendshëm apo të jashtëm;

2) me arsye beson se ka gjasa që dëshmitë në lidhje me veprimet e dëmshme përkatëse do të fshihen ose do të shkatërrohen;

3) autoritetet përgjegjëse për shqyrtimin e sinjalizimit të jashtëm dhe brendshëm nuk kanë ndërmarrë veprimet përkatëse brenda afatit prej gjashtë (6) muajsh nga momenti i raportimit të informacionit të sinjalizuar.

56 Situata e dytë përfshinë kriterin e katërt ligjor, sipas të cilit sinjalizuesi mund të bëjë shpalosjen e informacionit, përfshin rastet të cilat mund të konsiderohen të jashtëzakonshme, të përfshira në vijim:

1) kërcënimit të menjëhershëm për jetën;

2) shëndetit publik;

3) sigurisë;

4) mjedisit, apo

5) kur shkaktohen dëme në shkallë të gjerë apo dëme të pariparueshme.

Veprimi i sinjalizuesit në këto raste bëhet në interes publik, pasi konsiderohet se sinjalizim i brendshëm dhe i jashtëm nuk mund të jetë efektiv dhe mund të ketë pasoja për veprime të cilat mund të shkaktojnë pasoja të mëdha dhe të dëmshme për publikun.

³⁷ Shih Nenin 19 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit.

³⁸ Shih Nenin 14 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 7 / 01 mars 2019, Prishtinë.

57 Neni 20(2) i Ligjit përcakton se “Sinjalizuesi i cili shpalos informacionin tek publiku në pajtim me këtë ligj, është i obliguar të respektojë parimin e prezumimit të pafajësisë të personit të akuzuar, të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe të mos pengojë zhvillimin e procedurave gjyqësore”. Kjo dispozitë është e përgjithësuar dhe në fakt, fryma e ligjit është tjetër. Personi ndaj të cilit shpaloset informacioni në publik nuk është ende person i akuzuar por person ndaj të cilit ngritet pretendimi për shkelje. Statusin eventual të personit të akuzuar mund ta ketë vetëm pasi të bëhet filtri i informacionit të shpalosur nga organi kompetent dhe ngritja e aktakuzës.³⁹

Ligji përcakton se sinjalizuesi, përveç sinjalizimit të brendshëm dhe të jashtëm, mund të bëjë edhe sinjalizim publik apo shpalosjen e informacionit. Shpalosja nënkupton vënien e informacionit në dispozicion të publikut për shkeljet e pretenduara, dhe kjo mund të bëhet përmes mediave të shkruara dhe elektronike, OJQ-ve, organizimeve sindikale, shoqatave afariste, odave zejtare, tregtare, ekonomike, etj.

Sinjalizimi lidhur me sigurinë kombëtare dhe marrëdhëniet ndërkombëtare

58 Ligji në nenin 21, përcakton mekanizmat institucionalë (apo kanalet e raportimit) për sinjalizimin e brendshëm dhe të jashtëm lidhur me fushat që prekin sigurinë kombëtare dhe marrëdhëniet ndërkombëtare siç janë:

- 1) informacioni i klasifikuar;
- 2) siguria kombëtare;
- 3) mbrojtja;
- 4) inteligjenca dhe
- 5) marrëdhëniet ndërkombëtare.

Sipas kësaj dispozite, informacioni për shkeljen lidhur me këto fusha i paraqitet drejtpërdrejt organit komponent.

59 Informacioni i klasifikuar sipas legjislacionit përkatës është **“çdo informacion dhe material, publikimi i paautorizuar i të cilave do të cenonte në shkallë të ndryshme interesat e sigurisë së Republikës së Kosovës”**.⁴⁰ Legjislacioni përcakton nivelet e klasifikimit të informacionit dhe titullarët e institucioneve që kanë të drejtë të klasifikojnë këto informacione. Në rast të sinjalizimit të informacionit të klasifikuar, organi kompetent është Agjencia e Kosovës për Inteligjencë (AKI).⁴¹ AKI është organi kompetent edhe për trajtimin e sinjalizimit lidhur me fushën e inteligjencës. Në trajtimin e sinjalizimit që ka të bëjë me informacionin e klasifikuar dhe inteligjencën përdoren dispozitat e legjislacionit përkatës dhe parimet e ligjit për sinjalizimin.

³⁹ Neni 19(1.1.5) i Kodit për Procedurën Penale përcakton se: “I akuzuar - personi kundër të cilit është paraqitur aktakuza dhe është caktuar shqyrtimi gjyqësor”. Kodi Nr. 04/L-123 i procedurës penale/Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 37/28 dhjetor 2012, Prishtinë.

⁴⁰ Neni 3(1.1.5) i Ligjit për klasifikimin e informacioneve të klasifikuara dhe verifikimit të sigurisë.
⁴¹ Ibid. Neni 7.

60 Siguria dhe mbrojtja kombëtare kanë të bëjnë me ruajtjen e sovranitetit dhe integritetit territorial dhe rendit kushtetues të Republikës së Kosovës dhe marrëdhënieve me jashtë. Në rast të sinjalizimit lidhur me këto fusha, sinjalizuesi duhet të paraqes informacionin tek Forca e Sigurisë, Policia e Kosovës, Agjencia e Kosovës për Inteligjencë, Këshilli i Kosovës për Siguri dhe Autoriteti Civil i Aviacionit, si autoritete kryesore kushtetuese në garantimin e sovranitetit dhe integritetit territorial të vendit.⁴²

61 Marrëdhëniet ndërkombëtare janë marrëdhëniet midis shteteve, organizatave ndërkombëtare dhe subjekteve tjera të komunitetit ndërkombëtar. Pavarësisht se bartin pjesë të sovranitetit shtetëror në funksion të bashkëpunimit dhe forcimit të ligjit ndërkombëtar, në organizata rajonale dhe globale,⁴³ shtetet vijojnë të jenë aktorët kryesorë në marrëdhëniet ndërkombëtare. Dispozitat kushtetuese dhe ligjore mandatojnë tri institucione kryesore të Kosovës si organe kompetente në fushëveprim të marrëdhënieve ndërkombëtare: Presidentin, Qeverinë dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme. Nga kontekstualizimi me sinjalizimin në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare, konsiderohet se organ kompetent është Ministria e Punëve të Jashtme për shkak të mandatit dhe funksionit bashkërendues që ka me institucionet tjera në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare.⁴⁴

62 Për faktin se sinjalizimi lidhur me sigurinë kombëtare dhe marrëdhëniet ndërkombëtare është specifik, Ligji ka përcaktuar detyrimin e organeve përkatëse kompetente që në afat prej gjashtë (6) muajve nga hyrja në fuqi e ligjit të përcaktojnë rregulla dhe procedura për pranimin dhe trajtimin e llojeve të sinjalizimeve. Nëse këto institucione nuk përcaktojnë rregullat dhe procedurat e tilla, aplikohen rregullat e përgjithshme në përputhje me këtë ligj. Duke pasur parasysh ndjeshmërinë e trajtimit të informacionit të sinjalizimit lidhur me këto fusha, nxjerrja e rregullave dhe procedurave të veçanta nga organet kompetente duket e domosdoshme. Kjo për faktin se këto rregulla dhe procedura do të integronin dispozitat e këtij Ligji dhe legjisllacionit të fushave përkatëse dhe kjo do të mundësonte lehtësimin e sinjalizuesve për të raportuar por edhe lehtësimin e trajtimit të rasteve të raportuara.

Të drejtat e sinjalizuesit dhe personit të lidhur me sinjalizuesin

63 Sinjalizuesit i garantohen një korpus i të drejtave themelore në rast të sinjalizimit. Këto të drejta janë të bazuara në standardet ndërkombëtare të cilat mundësojnë që sinjalizuesi të ndjehet i sigurt për veprimin e vet. Tri të drejtat themelore që Ligji ia garanton sinjalizuesit janë:

- 1) mbrojtja e identitetit të sinjalizuesit gjatë procesit të sinjalizimit;
- 2) ruajtja e fshehtësisë së burimit të informacionit të sinjalizuar dhe
- 3) mbrojtja e sinjalizuesit kundër veprimeve të dëmshme.

Këto të drejta Ligji i garanton në tri situata:

- 1) gjatë kohëzgjatjes së procedurës së hetimit administrativ të sinjalizimit;
- 2) pas përfundimit të procedurës së hetimit administrativ dhe
- 3) pas përfundimit të marrëdhënies së punës me punëdhënësin e tij, kur nga rrethana të arsyeshme, sinjalizuesi ka kërkuar mbrojtjen e tij sipas këtij ligji.

64 Njëra prej të drejtave themelore është mbrojtja e të dhënave personale të sinjalizuesve dhe personave të tjerë që janë të përfshirë në një proces sinjalizimi, të dhëna të cilat përpunohen vetëm për qëllim të zbatimit të këtij ligji. Nëse gjatë trajtimit të informacioneve nga sinjalizuesi ka të dhëna tjera personale jo relevante, zyrtarët apo institucionet kompetente i shkatërrojnë apo asgjësojnë ato. Përpunimi i të dhënave personale të sinjalizuesve duhet të bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Mbikëqyrjen e zbatimit të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale nga mekanizmat institucionalë, ankesat, apo çështjet tjera lidhur me të dhënat personale gjatë procesit të sinjalizimit, janë fushëveprim i Komisionerit të Agjencisë për Informim dhe Privatësi.⁴⁵

42 Shih: Kapitulli XI, i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Sektori i Sigurisë.

43 Neni 20(1) i Kushtetutës së Kosovës përcakton: "Republika e Kosovës, në bazë të marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare, për çështje të caktuara mund të kalojë kompetenca shtetërore organizatave ndërkombëtare.

44 Shih Nenin 3 të Ligjit Nr. 03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: Viti III / nr. 26 / 02 qershor 2008.

45 Shih Ligji Nr. 06/ 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 6/25 shkurt 2019, Prishtinë.

65 Sinjalizuesit janë persona që kanë raporte apo kontakte të ndryshme me persona të tjerë. Mund të ngjajë që sinjalizuesi të ndihmohet gjatë një procesi të sinjalizimit nga persona të tjerë. Por edhe mund të ngjajë që një person për shkak të çfarëdo lidhje me sinjalizuesin të përjetojë ndonjë formë të hakmarrjes apo të dëmtohet. Ligji, këtë person e definon si person të lidhur me sinjalizuesin. Personi i lidhur me sinjalizuesin është ai personi i cili ndihmon sinjalizuesin ose mund të ofrojë prova të lidhura me sinjalizimin apo çdo person tjetër që mund të dëmtohet për shkak të çfarëdo lidhjeje me sinjalizuesin.

66 Ligji garanton se personi i lidhur me sinjalizuesin gëzon të njëjtën mbrojtje sikurse sinjalizuesi nëse provon se:

- 1) veprimi i dëmshëm është ndërmarrë kundër tij për shkak të lidhjes së tij me sinjalizuesin;
- 2) veprimi i dëmshëm është ndërmarrë kundër tij për shkak se personi që ndërmerr veprimin e dëmshëm beson gabimisht se ai është sinjalizues ose person i lidhur me sinjalizuesin.

Kjo mbrojtje vlen edhe për personat përgjegjës (*zyrtarin e caktuar për sinjalizim në institucionin përkatës dhe titullarin e institucionit*) në rast se pësojnë apo iu shkelet ndonjë e drejtë si pasojë e sinjalizimit.

Njëra prej të drejtave themelore është mbrojtja e të dhënave personale të sinjalizuesve dhe personave të tjerë që janë të përfshirë në një proces sinjalizimi, të dhëna të cilat përpunohen vetëm për qëllim të zbatimit të këtij ligji.

Mbrojtja gjyqësore e sinjalizuesit

67 Mbrojtja e sinjalizuesit është thelbi i Ligjit. Personi që raporton apo shpalos informata, sipas Ligjit nuk mund të jetë subjekt i përgjegjësisë penale, civile apo disiplinore. Sinjalizuesi gëzon të drejtën e mbrojtjes ligjore në rastet kur me arsye beson se informacioni i raportuar apo i shpalosur është i vërtetë. Sinjalizuesi nuk është i detyruar të provojë mirëbesimin dhe vërtetësinë e informacionit të sinjalizuar, dhe sinjalizuesi nuk ka detyrim të mbledhë apo sigurojë prova. Ligji përcakton se mbrojtja e garantuar për sinjalizuesin nuk duhet të paragjykohet nëse kërcënimi apo cenimi i interesit publik i pretenduar përmes sinjalizimit nuk është materializuar. Për të gëzuar mbrojtjen ligjore, sinjalizuesit duhet të kenë arsye të besojnë - në dritën e rrethanave dhe informacionit të disponueshëm për ta në kohën e raportimit apo shpalosjes së informacionit të tyre - se çështjet e sinjalizuara janë të vërteta.

68 Sinjalizuesi mbrohet nga çdo veprim i dëmshëm i marrë ndaj tij nga punëdhënësi për shkak të sinjalizimit në pajtim me dispozitat e këtij ligji, duke përfshirë por pa u kufizuar nga veprimet si në vijim:

- 1) shkarkimin nga puna;
- 2) pezullimin nga puna ose të një ose më shumë detyrave;
- 3) transferimin brenda ose jashtë institucionit publik ose subjektit privat pa pëlqimin e tij;
- 4) uljen në pozitë;
- 5) zvogëlimin e pagesës;
- 6) humbjen e statusit dhe privilegjeve;
- 7) mosngritjen në pozitë;
- 8) heqjen e të drejtës për të marrë pjesë në trajnime;
- 9) vlerësime negative në marrëdhënien e punës;
- 10) anulimin e një licence ose leje;
- 11) përfundimin e një kontrate për mallra apo shërbime;
- 12) veprime të tjera të dëmshme në lidhje me marrëdhënien e punës.

69 Mbrojtja efikase gjyqësore e sinjalizuesit paraqet një prej elementeve më të rëndësishme të këtij Ligji. Nëse sinjalizuesi u nënshtrohet veprimeve të dëmshme në vendin e punës apo dëmtohet për shkak të sinjalizimit, ka të drejtë që t'i drejtohet gjykatës kompetente duke kërkuar edhe dëmshpërblim për dëmin e pësuar bazuar në legjislacionin në fuqi. E drejta jonë pozitive përcakton qartë rregullat për dëmshpërblim. Në bazë të numërimit taksativ të veprimeve të dëmshme, të përcaktuara në nenin 22 të Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, shihet se shumica e tyre janë të kategorisë së dëmshpërblimit jo material, pra, kanë të bëjnë me cenimin e të drejtës së personalitetit.⁴⁶

70 Ligji garanton se sinjalizuesi ka të drejtë në mbrojtje gjyqësore, drejtpërdrejtë, pa qenë i detyruar të shterrojë mjetet juridike të brendshme të procedurës administrative. Mjet juridik i brendshëm në procedurën administrative është ankesa. Ligji përcakton se kushdo që në cilësinë e sinjalizuesit pëson nga një veprim i dëmshëm mund të parashtrojë padi në gjykatë. Padia mund t'i parashtrohet gjykatës në afat prej gjashtë (6) muajsh nga dita kur sinjalizuesi është vënë në dijeni, por jo më vonë se tri (3) vite nga dita kur është ndërmarrë veprimi i dëmshëm.

Krahas parashtimit të padisë, i dëmtuari mund të parashtrojë edhe kërkesën për kompensim të dëmit, në pajtim me legjislacionin në fuqi. Ligji përcakton dy procedura lidhur me parashtimin e padive në gjykatë rreth mbrojtjes së sinjalizuesve.

71 Për rastet që kanë të bëjnë me shërbyesit civilë (nëpunësit civil në fakt)⁴⁷ padia parashtrohet në Departamentin për Çështje Administrative në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Ky departament ka juridiksion në gjithë territorin e vendit, dhe gjykon dhe vendos në konfliktet administrative sipas padive kundër akteve administrative përfundimtare dhe për çështjet e tjera të përcaktuara me ligj.⁴⁸ Ligji emërton “nëpunësit civil” si “shërbyes civil” por legjislacioni përkatës për zyrtarët publikë përcakton katër kategori të zyrtarëve publikë:

- 1) nëpunësi i Shërbimit Civil (në tekstin në vijim: nëpunësi civil);
- 2) nëpunësi i Shërbimit Publik;
- 3) nëpunësi i Kabinetit; dhe
- 4) nëpunësi administrativ dhe mbështetës.

72 Në kontekst të mbrojtjes gjyqësore të sinjalizuesit, padi në konflikt administrativ mund të parashtrojnë vetëm nëpunësit civil dhe jo kategoritë tjera të zyrtarëve publikë. Tri kategoritë tjera të zyrtarëve publikë dhe të punësuarit në sektorin privat mund të parashtrojnë padi lidhur me mbrojtjen gjyqësore nga veprimet e dëmshme lidhur me sinjalizimin në Departamentin e Përgjithshëm të Gjykatës Themelore. Lidhur me kompetencën territoriale, Ligji përcakton se gjykatë kompetente mund të jetë Gjykata Themelore ku ndodhet selia e punëdhënësit apo ku sinjalizuesi e ka vendbanimin.⁴⁹

73 Ligji ka përcaktuar se në rast se gjykata vërteton se sinjalizuesi ka pësuar nga veprimet e dëmshme, ajo mund të vendosë sipas rastit si vijon:

- 1) ta kthejë në vendin e punës;
- 2) t'ia kompensojë dëmin e shkaktuar; dhe
- 3) ta urdhërojë institucionin publik apo privat të ndërmarrë veprime të caktuara.

Sa i përket veprimeve të caktuara të cilat mund t'i theksojë gjykata në vendimin e saj, ato mund të jenë:

- 1) ndërmarrja e masave adekuate lidhur me krijimin e kushteve për kthim në vend të punës, apo
- 2) respektimi i vendimit të organit i cili ka urdhëruar kthimin e tij në vend të punës, etj.

Lëndët që kanë të bëjnë me sinjalizimin trajtohen me prioritet nga Gjykatat.

74 Një e drejtë shumë e rëndësishme ligjore në rastet e sinjalizimit ka të bëjë me barrën e provës (onus probandi). Barra e provës është e drejta dhe detyrimi i palës që në një proces ligjor për të provuar atë që pretendon mbi një fakt ose të dhëna që kanë ndikim përcaktues në zgjedhjen përfundimtare të çështjes. Në të gjitha rastet kur sinjalizuesi apo personi i lidhur me sinjalizuesin pretendon se ka pësuar nga veprime të dëmshme për shkak të sinjalizimit, barra e provës i takon punëdhënësit se veprimi i dëmshëm nuk ka lidhje shkakore me sinjalizimin.

46 Shih Ligji Nr. 16-L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (nenet 169-192). Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr. 16 / 19 qershor 2012, Prishtinë.

47 Sipas përkufizimit ligjor: “Nëpunës civil - është zyrtari publik në kuadër të Shërbimit Civil, i cili ushtron detyrën në një pozitë, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e sekretarit të përgjithshëm në administratën e Presidentit, në administratën e Kuvendit, në Zyrën e Kryeministrit, në ministri, në agjenci ekzekutive, në agjenci dhe në një degë lokale të tyre, në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë, në institucion të pavarur, në agjenci të pavarur, në administratën komunale dhe çdo nëpunës i përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë”. Neni 2, i Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë/ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /nr. 8 /11 mars 2019, Prishtinë

48 Neni 17(1) i Ligjit Nr. 06/L- 054 për Gjykatat / Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 22 /18 dhjetor 2018, Prishtinë.

49 Neni 17(1) i Ligjit Nr. 06/L - 054 për Gjykatat.

75 Në korpusin e garancive ligjore për mbrojtjen e të drejtave të sinjalizuesit dhe personit të lidhur me të, është edhe e drejta e propozimit të gjykatës kompetente për masat e sigurimit të kërkesëpadisë. Sigurimi i kërkesëpadisë bëhet sipas dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe Ligjit për Konfliktet Administrative. Realizimi i të drejtave të individit në procedurë civile mund të zgjasë shumë, dhe për këtë arsye, paraqitet nevoja për të shqiptuar masat e përkohshme të sigurisë deri në vendosjen e çështjes kryesore. Llojet e masave të sigurisë dhe procedura për propozimin e tyre janë të rregulluara me Ligjin për Procedurën Kontestimore, dispozitat e të cilit zbatohen në rastet e tilla për sinjalizues.⁵⁰ Sinjalizuesi poashtu është i liruar nga detyrimi për deponimin e garancisë në gjykatë për shkak të paraqitjes së propozimit për caktimin e masës së sigurimit. Poashtu, edhe dispozitat e Ligjit për Konfliktet Administrative mund të përdoren lidhur me sigurimin e kërkesëpadisë së sinjalizuesit.⁵¹

Ligji garanton se sinjalizuesi ka të drejtë në mbrojtje gjyqësore, dhe drejtpërdrejt të parashtrijë padi në gjykatë pa qenë i detyruar të shterojë mjetet juridike të brendshme të procedurës administrative.

⁵⁰ Shih Kreu XXI –Sigurimi i Kërkesë padisë–Ligji Nr. 03/l-006 për Procedurën Kontestimore. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: Viti II / nr. 38 / 20 shtator 2008.

⁵¹ Neni 22(2) i Ligjit për Konfliktet Administrative përcakton: “Me kërkesën e paditësit, organi, akti i të cilit ekzekutohet, gjegjësisht organi që është kompetent për ekzekutim, mund ta shtyjë ekzekutimin deri në vendimin definitiv gjyqësor, nëse ekzekutimi do t'i sillte dëm paditësit, i cili vërshtirë do të riparohet, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare, përkatësisht personit të interesuar.” Ligji nr. 03/l-202 për Konfliktet Administrative./Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: viti v / nr. 82 / 21 tetor 2010

Sanksionet kundërvajtëse

76 Neni 27 i Ligjit përcakton sanksionet kundërvajtëse në rast të pengimit të sinjalizimit, dështimit të institucionit rreth zbatimit të këtij ligji apo mbrojtjes së sinjalizuesit. Kundërvajtje është sjellja me të cilën shkelet ose rrezikohet rendi dhe qetësia publike dhe vlerat shoqërore të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, mbrojtja e të cilave nuk është e mundur pa sanksionimin kundërvajtës.⁵² Sipas Ligjit për Kundërvajtje, gjoba është sanksioni kryesor kundërvajtës. Gjykata mund të shqiptojë dënim me gjobë për personin juridik (punëdhënësin) të sektorit publik apo privat dhe për personin fizik të personit juridik.

77 Për punëdhënësin e sektorit privat apo publik dhe organin (autoritetin) kompetent, gjykata shqipton gjobë prej pesëqind (500) deri në njëzetmijë (20.000) euro në rastet si vijon:

- 1)** punëdhënësi nuk e mbron sinjalizuesin nga ndonjë veprim i dëmshëm ose nuk ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për ndërprerjen e veprimit të dëmshëm, si dhe eliminimin e çdo pasoje të veprimit të dëmshëm brenda kompetencave të veta;
- 2)** nuk njofton me shkrim të gjithë të punësuarit lidhur me të drejtat që parashihen në këtë ligj;
- 3)** nuk cakton zyrtarin përgjegjës;
- 4)** nuk ndërmerr veprime pas raportimit të informacionit brenda afatit të përcaktuar me këtë ligj;
- 5)** nuk informon sinjalizuesit për rezultatin e procedurës brenda afatit të përcaktuar;
- 6)** nuk informon sinjalizuesin, sipas kërkesës së tij, lidhur me ecurinë dhe veprimet e ndërmarra në procedurë, ose nuk i mundëson sinjalizuesit që të ketë qasje në shkresat e lëndës dhe që të marrë pjesë në veprimet e ndërmarra gjatë procedurës së sinjalizimit;
- 7)** në rast se pengon sinjalizimin dhe
- 8)** në rast se nuk mbron të drejtat e personit të lidhur me sinjalizuesin.

⁵² Neni 2(1) i Ligjit Nr. 05/l-087 për Kundërvajtje / Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /nr. 33 /8 shtator 2016, Prishtinë

78 Për zyrtarin përgjegjës të institucionit publik, të subjektit privat si dhe të autoritetit kompetent përkatës, gjykata shqipton gjobë prej treqind (300) euro deri në dymijë (2.000) euro në rastet si vijon:

- 1) nuk mbron sinjalizuesin nga ndonjë veprim i dëmshëm ose nuk ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për ndërprerjen e veprimit të dëmshëm si dhe eliminimin e çdo pasoje të veprimit të dëmshëm brenda kompetencave të veta;
- 2) nuk njofton me shkrim të gjithë të punësuarit lidhur me të drejtat që parashihen më këtë ligj;
- 3) nuk ndërmerr veprime pas raportimit të informacionit brenda afatit të përcaktuar me këtë ligj;
- 4) nuk informon sinjalizuesin sipas kërkesës së tij lidhur me ecurinë dhe veprimet e ndërmarra në procedurë, ose nuk i mundëson sinjalizuesit që të ketë qasje në shkresat e lëndës dhe që të marrë pjesë në veprimet e ndërmarra gjatë procedurës së sinjalizimit.

79 Neni 27(5) përcakton se: “Nëse personi përgjegjës është recidivist, ndaj tij mund të shqiptohet sanksioni kundërvajtës me gjobë deri në shumën e dyfishuar të paraparë me këtë nen”. Personi përgjegjës ndaj të cilit është shqiptuar sanksioni kundërvajtës edhe më parë dhe përsëritë veprimet kundërvajtëse, gjykata i shqipton dënimin me gjobë deri në katërmijë (4.000) euro. Po ashtu, termi “person përgjegjës” në kuptim të këtij neni nuk përfshin vetëm zyrtarin përgjegjës të punëdhënësit në sektorin publik apo privat, por edhe persona tjerë përgjegjës, si titullari i institucionit në raste të caktuara.

80 Kërkesa për fillimin e procedurës së kundërvajtjes paraqitet në gjykatën kompetente nga Agjencia kundër Korrupsionit - për sektorin publik, dhe Inspektorati i Punës⁵³ - për sektorin privat, si dy agjencitë qendrore për zbatimin e këtij ligji. Nëse brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve institucionet përgjegjëse nuk ndërmarrin asnjë veprim apo refuzojnë të veprojnë, atëherë sinjalizuesi mund të iniciojë vetë procedurën.

Mbrojtja e sinjalizuesve në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

81 Standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e sinjalizuesve janë zhvilluar nga praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ). Kjo praktikë është mishëruar nga vendimet e kësaj gjykate lidhur me interpretimin e dispozitave të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).⁵⁴ Liria e shprehjes, e mbrojtur me nenin 10 të Konventës, konsiderohet si një ndër shtyllat e demokracisë. Ajo është kusht qenësor për gëzimin e shumë lirive dhe të drejtave të tjera, dhe është poshtu shprehje e realizimit të lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe religjionit, liri këto të mbrojtura me nenet tjera të Konventës.

82 Neni 10 i KEDNJ, përcakton lirinë e shprehjes si në vijim:

- 1) Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon shtetet që t'u kërkojnë ndërmarrjeve të transmetimit audioviziv, televiziv ose kinematografik të pajisen me licencë;
- 2) Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t'u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.⁵⁵

⁵³ Neni 2 i Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës përcakton: Inspektorati i Punës mbikëqyrë zbatimin e dispozitave ligjore dhe nënligjore në lëminë e punës në mënyrë gjithpërfshirëse duke përfshinë marrëdhëniet e punës, sigurinë në punë, mbrojtjen e shëndetit të punësuarve dhe ambientit të punës. Ligji Nr. 03/1-017 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për inspektoratin e punës nr. 2002/9. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: Viti iii / nr. 37 / 10 shtator 2008

⁵⁴ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 22 të saj përcakton se Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, zbatohet drejtdrejtë në Republikën e Kosovës dhe dispozitat e saj kanë prioritet në rast konflikti ndaj dispozitave të ligjeve apo akteve të tjera të insitucioneve publike. Përvëç Konventës drejtdrejtë të zbatueshme në Kosovë janë disa prej instrumenteve themelore ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut: Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut; Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Protokollet e saj; Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare; Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor; Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Gruas; Konventa për të Drejtat e Fëmijës; Konventa Kundër Torturës dhe Trajtimeve dhe Ndëshkimeve tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese;

⁵⁵ https://www.echr.coe.int/Documents/Convention_SQL.pdf

83 KEDNJ është një instrument i “gjallë”, dinamik, i cili është pasuruar në vazhdimësi dhe në tekstin e saj përfshin interpretimet e GJEDNJ, ndërsa rëndësia qëndron tek precedentët gjyqësor. GJEDNJ ka gjykuar shumë raste që kanë të bëjnë me të drejtën e lirisë së shprehjes. Megjithatë, Konventa përcakton që liria e shprehjes përmban edhe detyra dhe përgjegjësi dhe mund t’i nënshtrohet kufizimeve të ndryshme, “të domosdoshme për shoqërinë demokratike”. GJEDNJ, në mënyrë strikte, i ka zbatuar këto kufizime. Për shembull, në rastin *Handyside v. Mbretëria e Bashkuar*, të vitit 1976, Gjykata kishte vendosur që Mbretëria e Bashkuar me arsye kishte ndaluar publikimin e librit “The Little Red School Book”, për shkak se ky libër kishte përmbajtje të papërshtatshme që konsiderohej “publikim i pahijshëm”, duke pasur parasysh efektet që mund t’i kishte tek lexuesit e rinj.⁵⁶ Ky rast ishte thelbësor në jurisprudencën e Gjykatës në lidhje me balancimin e të drejtës së lirisë së shprehjes dhe kufizimeve të saj, duke ndërtuar kështu konceptin bazë për trajtimin e ardhshëm të mbrojtjes së sinjalizuesve.

84 Lidhur me mbrojtjen e sinjalizuesve, GJEDNJ ka nxjerrë poashtu disa vendime duke iu referuar pikërisht lirisë së shprehjes. Këto raste janë: *Guja v. Moldavisë* (2008); *Marchenko v. Ukrainës* (2009); *Kudeshkina v. Ruisë* (2009); *Heinisch v. Gjermanisë* (2011); *Bucur dhe Toma v. Rumanisë* (2013); dhe *Matúz v. Hungarisë* (2014). Sipas jurisprudencës së Gjykatës, të punësuarit kanë të drejtën e lirisë së shprehjes për të informuar publikun për shkelje ligjore që ndodhin në ambientin e punës.

Liria e shprehjes e mbrojtur me nenin **10** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, konsiderohet si një ndër shtyllat kryesore të demokracisë.

85 Rasti i parë lidhur me mbrojtjen e sinjalizuesve i trajtuar nga GJEDNJ në vitin 2008, është rasti i njohur *Guja v. Moldavisë*. Parashtruesi i kërkesës ishte Iacob Guja, ish shef i Departamentit të Shtypit të Prokurorisë së Përgjithshme. Parashtruesi i kërkesës i kishte dërguar shtypit dy letra, asnjëra prej të cilave nuk ishte e shenjëzuar si konfidenciale. Letrat mbështesnin pretendimet se ka pasur ndërhyrje të politikës në punën e prokurorisë. Si rezultat i këtij zbulimi, parashtruesi i kërkesës më vonë është shkarkuar nga posti i tij. Guja ishte i mendimit se letrat nuk ishin konfidenciale për shkak se ato zbuluan ndikimin e parlamentit dhe të politikës në punën e prokurorisë. Të gjitha gjykatat në Moldavi kishin vendosur kundër tij duke mos e kthyer në punë. Duke u mbështetur në nenin 10 të Konventës, ai u ankua në GJEDNJ duke paditur shtetin moldav për shkelje të lirisë së shprehjes në vendin e punës. GJEDNJ vendosi në favor të tij dhe në të njëjtën kohë vendosi standardet thelbësore lidhur me mbrojtjen e sinjalizuesve. Sipas gjykatës, sinjalizuesi gëzon mbrojtje nëse institucioni nuk ka procedurë për sinjalizimin dhe nëse procedurat nuk ishin të përshtatshme. Gjykata vendosi edhe standardin se interesi publik është më i lartë se interesat tjera.⁵⁷

86 Neni 53 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] përcakton se: **“Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”**. Sipas këtij neni, është e qartë se praktika gjyqësore e GJEDNJ është e detyrueshme për të gjitha autoritetet publike në Kosovë.

Sipas Kushtetutës së Kosovës praktika gjyqësore e GJEDNJ, është e detyrueshme për të gjitha autoritetet publike në Kosovë.

⁵⁶ Rasti mund shkarkohet në : <https://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-57499/>

⁵⁷ Rasti mund të shkarkohet në: <https://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-85016.>

Perspektiva e zbatimit të Ligjit

87 Sinjalizimi i shkeljeve apo praktikave të dyshimta ndikon në forcimin e rendit dhe ligjit, fuqizimin e integritetit institucional dhe zhvillimit ekonomik të vendit. Sipas konceptit modern, sinjalizimi nuk bëhet vetëm për qëllim të zbulimit të shkeljeve ligjore apo praktikave të dyshimta, por bëhet në rend të parë, për t'i parandaluar ato. Pra jo për të zbuluar mollat e kalbura në organizatën punëdhënëse, por për të parandaluar kalbjen e tyre. Ligji ofron një kornizë të avancuar për sinjalizim dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, në pajtim me standardet ndërkombëtare.

88 Zbatimi efikas i Ligjit kërkon angazhim të komunitetit institucional dhe qytetar. Institucionet përgjegjëse duhet të përfundojnë nxjerrjen e akteve nënligjore për zbatimin e Ligjit dhe marrjen e veprimeve konkrete për udhëzimin e të punësuarëve në sektorin publik dhe privat për zbatimin e tij. Organizatat punëdhënëse duhet të caktojnë zyrtarët përgjegjës dhe njoftimin e të punësuarëve për procedurën e sinjalizimit. Punëdhënësit duhet të ndërtojnë një politikë integruese duke zbatuar njëkohësisht dispozitat e këtij ligji, kodit të etikës dhe planeve të integritetit brenda tyre.

89 Raportimet vjetore nga institucionet qendrore zbatuese, si Agjencia Kundër Korrupsionit dhe Inspektorit i Punës, po ashtu janë me shumë rëndësi. Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit duhet të jetë prioritet edhe në agjendën e Komisioneve Parlamentare të Kuvendit të Kosovës. Poashtu, autoritetet publike duhet t'i referohen jurisprudencës së GJEDNj-së për mbrojtjen e sinjalizuesve.

90 Roli i organizatave të shoqërisë civile dhe mediave është thelbësor në zbatimin e këtij Ligji. Përmes organizmit të fokus grupeve, tryezave, publikimeve, broshurave, raportimeve, etj., mediat dhe shoqëria civile japin kontribut të pazavendësueshëm në rritjen e vetëdijësimin për rëndësinë e sinjalizimit si dhe për krijimin e mirëbesimit ndërmjet të punësuarve në sektorin publik dhe privat dhe institucioneve.

Referencat:

1. Gaps in the System: Whistleblowers Laws in the EU” (2018), Autor: M. Worth; bashkautor: S. Dreyfus dhe G. Hanley.
2. Mark Worth and DrSuelette Dreyfus, Cannelle Lavite, Garreth Hanley, ”Safe or Sorry: Whistleblower Protection Laws in Europe Deliver Mixed Results” (2018 Blueprint for Free Speech).
3. F. Kusari, Sinjalizuesi i dyfishtë Thaçi’ <https://sbunker.net/teh/42789/sinjalizuesi-i-dyfishte-thaci/>
4. F. Kusari, ‘Whistleblowers in Kosovo Struggle for Protection’. Southeast European Coalition on Whistleblower Protection, (9 September 2016) <https://see-whistleblowing.org/whistleblowers-in-kosovo-struggle-for-protection/>.
5. K.Gashi, “Kosovo: The Republic without Whistleblowers. Balkan Investigative Reporting Network and Southeast Europe Coalition on Whistleblower Protection (12 September (2016))<https://see-whistleblowing.org/kosovo-the-republic-without-whistleblowers/>
6. Kushtetuta e Republikës së Kosovës.
7. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut.
8. Wim Vandekerckhove, Udhëzuesi për Mbrojtjen e Sinjalizuesve; Këshilli i Evropës, Qershor 2019.
9. Bahrie Lecaj, Udhëzuesi “Komunikimi efektiv përmes postës elektronike – email”, Dhjetor 2013 USAID.
10. Kodi Nr.06/l-074 Penal i Republikës së Kosovës/Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /nr. 2/14 janar 2019, Prishtinë.
11. Ligji Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 22 /18 Dhjetor 2018, Prishtinë.
12. Direktiva e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të Bashkimit Evropian për Mbrojtjen e Personave që Raportojnë Shkeljen e Ligjit në Bashkimin Evropian.
13. Rekomandimi i Këshillit të Evropës (2014)7.
14. Ligji Nr.05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi; Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr. 16/6 Qershor 2015, Prishtinë.
15. Ligji Nr. 03/L- 159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, / Nr.65/05 Shkurt 2010, Prishtinë.
16. Ligji Nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 5/27 Prill 2018, Prishtinë.
17. Ligji Nr.03/L-063 për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr. 30/15 Qershor 2008, Prishtinë.
18. Ligji Nr. 03/L-178 për Klasifikimin e Informacionit dhe Verifikimin e Sigurisë, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /Viti V/ Nr. 76/10 Gusht 2010, Prishtinë.
19. Ligji Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 22/18 Dhjetor 2018, Prishtinë.
20. Ligji Nr. 06/L -016 për Shoqëritë tregtare, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 9/24 Maj

- 2018, Prishtinë
21. Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën Administrative, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Nr. 20/21/ Qershor 2016, Prishtinë.
 22. Ligji Nr. 06/ 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 6 /25 Shkurt 2019, Prishtinë.
 23. Ligji nr. 03/l-202 për Konfliktet Administrative, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /Prishtinë: viti v/nr. 82/21 tetor, 2010.
 24. Ligji Nr. 06/l -113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 7/01 mars 2019, Prishtinë.
 25. Ligji Nr. 16-L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve / Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr. 16/19 qershor 2012, Prishtinë
 26. Neni 17(1) i Ligjit Nr. 06/L- 054 për Gjykatat /Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /nr. 22/18 dhjetor 2018, Prishtinë.
 27. Ligji Nr. 06/l -114 për Zyrtarët Publikë/ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /nr. 8/11 mars 2019, Prishtinë.
 28. Ligji Nr. 05/l-087 për Kundërvajtje/ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 33/8 shtator 2016, Prishtinë
 29. Ligji Nr. 03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: Viti III / nr.26/02 qershor 2008.
 30. Ligji Nr. 03/l-017 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për inspektoratin e punës nr. 2002/9. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: Viti iii / nr. 37 / 10 shtator 2008
 31. Ligjin Nr. 01, 02 -02010-39/13 date 16.12. 2013 për mbrojtjen e personave që raportojnë korrupsion në institucionet e Bosnje dhe Hercegovinës,
 32. Ligjin nr. 60/2016 për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve në Shqipëri.
 33. Rasti i GJEDNJ; Guja v. Moldavise ; <https://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-85016>.
 34. Rasti i GJEDNJ: Handyside v. U.K, <https://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-57499/>

Katalogimi në botim – **(CIP)**

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

35(035)

Çeku, Nur

Manual për zbatimin e ligjit nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve / Nur Çeku – Prishtinë: Qendra për studime të avancuara FIT, 2019 – 43 f. ; 21cm

ISBN 978-9951-691-03-1

ISBN 978-9951-691-03-1



9 789951 691031